



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e hënë, më 15 maj 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Armela</b>	<b>KRASNIQI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Desada</b>	<b>METAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Aurela</b>	<b>BICJA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Besian</b>	<b>ZOGAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gjergji</b>	<b>HAMITI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Jetmir</b>	<b>HALILAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Joana</b>	<b>ALLUSHI</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 6-14 maj 2023 (**Vendimi nr. 39, datë 15.05.2023**).
2. Dhënien e autorizimit të subjektit person fizik Nikoll Marinaj, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Marinaj Internet-Kabllor”, me NIPT: L58415701I dhe zonë ofrimi shërbimi “*Njësitë administrative Koplík dhe Kastrat (të bashkisë Malësi e Madhe)*”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare (**Vendimi nr. 40, datë 15.05.2023**).
3. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “ITCOM” sh.p.k, me NIPT: K87230005V, administrator z. Valentin Palushaj, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor ITCOM”, me zonë ofrim shërbimi “*Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz*”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare (**Vendimi nr. 41, datë 15.05.2023**).

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 15 maj 2023**

